

## **Raporti për të Drejtat e Njeriut për vitin 2010: Shqipëria (8 Prill 2011)**

### **BYROJA E DEMOKRACISË, TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE PUNËS** **Raportet e Vendeve mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2010** **8 prill, 2011**

Republika e Shqipërisë është demokraci parlamentare me një popullsi prej afërsisht tre milionë banorë. Kushtetuta ia njeh autoritetin legjislativ Kuvendit Popullor (parlamentit) me një dhomë, i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri kryeson qeverinë, ndërkohë që presidenti ka pushtet të kufizuar ekzekutiv. Në qershor të vitit 2009 vendi zhvilloi zgjedhje parlamentare, të cilat Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE) i përshkroi si zgjedhje që shënuan përparim krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, por që nuk përmbushën plotësisht angazhimet e OSBE-së. Ndërkohë që votoi për certifikimin e zgjedhjeve si të ligjshme dhe përfundimtare, Partia Socialiste (PS) e opozitës nisi bojkotimin e parlamentit në shtator të vitit 2009, duke bërë thirrje për hetim mbi pretendime për mashtrim elektoral. Bojkoti vazhdoi deri në fund të vitit. Forcat e sigurisë i raportnin autoriteteve civile.

Sipas raportimeve, policia rrahu dhe keqtrajtoi rëndë të dyshuarit gjatë marrjes në pyetje dhe gjatë ndalimit. U raportuan disa raste keqtrajtimi fizik në burgje. Korrupsioni në radhët e policisë dhe mosndëshkueshmëria vazhduan. Korrupsioni në qeverisje mbeti problem serioz dhe i pazgjidhur. Përbënin problem diskriminimi ndaj femrave, fëmijëve, personave homoseksualë dhe pakicave. Trafikimi i qenieve njerëzore mbeti gjithashtu problem.

### **RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Seksioni 1 Respekti për Integritetin e Personit, Përfshirë Lirinë Nga:

#### **a. Mohimi Arbitrar apo i Jashtëligjshëm i Jetës**

Nuk pati raportime që qeveria apo agjentët e saj të kenë kryer vrasje arbitrare apo të jashtëligjshme. Vrasjet e dy figurave politike – deputetit të Partisë Socialiste Fatmir Xhindi dhe një udhëheqësi Demokristian Aleks Keka – ishin nën hetim dhe mbetën të pazgjidhura deri në fund të vitit.

Më 12 dhjetor, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës nxorri raportin e reporterit të KE-së, Dick Marty, mbi deklaratën në lidhje me trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin të paligjshëm të organeve njerëzore. Raporti deklaronte se, nga korriku i vitit 1999 deri në mesin e vitit 2000, elementë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe degëve të saj mbajtën dhjetëra persona “të zhdukur” në vendodhje të përkohëshme në Bicaq, Burrel, Rripe dhe Fushë Krujë. Raporti pohonte se disa prej këtyre personave iu ishin hequr veshkat për t’u përdorur nga një rreth ndërkombëtar i trafikimit të organeve. Raporti pohonte se shumica e personave të mbajtur – shqiptarë dhe serbë etnikë të cilët sipas UÇK-së ishin bashkëpunëtorë - supozohej se ishin vrarë. Sipas raportit, burime të dorës së parë në mënyrë të besueshme implikonin pesë anëtarë të “Grupit Drenica” brenda UÇK-së duke thënë se ata urdhëronin, në disa raste madje të parë personalisht, vrasje, ndalime, rrahje dhe marrje në pyetje në lidhje me veprimet e udhëhequra nga UÇK-ja në territorin e Shqipërisë, ndërmjet viteve 1998 dhe 2000. Raporti deklaronte

gjithashtu se koka e Grupit Drenica, Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, vepronte me “mbështetjen dhe bashkëpunimin” e qeverisë, shërbimit sekret dhe mafias së Shqipërisë. Autoritetet shqiptare e kundërshtuan përmbajtjen e raportit por u zotuan për bashkëpunim në hetime në lidhje me të.

Misioni i Përkohshëm për Administrimin e Kosovës i Kombeve të Bashkuara (UMNIK) dhe Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve për ish Jugosllavinë, mandatet e së cilës nuk shtriheshin deri në Shqipëri, i hetuan më parë deklaratat që bëheshin në raportin e Marty-t për kultivim organesh dhe dolën në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme për të vazhduar çështje penale.

Njësia për Krimet e Luftës e Misionit European për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) mbajti hetim të hapur por joaktiv në lidhje me deklaratat për trafikim organesh. Njësia për Krimet e Luftës e EULEX-it pohoi se nuk kishte prova në lidhje me këto deklarata dhe u bëri thirrje KiE-së dhe palëve të tjera të sillnin çfarëdo lloj prove që zotëronin. Me daljen e raportit të KiE-së, EULEX-i tregoi se i mungonte jurisdiksioni për të hetuar krimet e dyshuara në territorin e Shqipërisë. Megjithatë, qeveria shprehu publikisht vullnetin për të bashkëpunuar në hetimin për këto krime të dyshuara.

Gjatë vitit pati raportime të vazhdueshme për vrasje shoqërore, përfshi edhe “gjakmarrjet” mes brezave dhe vrasjet për hakmarrje. Vrasje të tilla hera-herës përfshinin banda kriminale. Sipas Ministrisë së Brendshme, pati pesë vrasje të lidhura me gjakmarrjen gjatë vitit. Megjithatë, OJQ-të raportuan 55 vrasje të lidhura me gjakmarrjen gjatë vitit. Sipas OJQ-ve, afro 1490 familje ishin faktikisht të burgosura në shtëpitë e tyre nga frika e ndëshkimeve për shkak të gjakmarrjes. Gjykata për Krimet e Rënda gjykoi çështje të lidhura me gjakmarrjen. Ligji ndëshkon vrasjen me paramendim, kur kryhet për hakmarrje apo gjakmarrje, me 20 vjet burg ose burgim të përjetshëm.

#### b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje me motive politike.

Prokurorët shqiptarë besonin se kishin gjetur vendndodhjen e Ilir Kumbaros, në gjykim bashkë me tre prej kolegëve të tij të Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH) për rrembimin dhe torturimin e Remzi Hoxhës dhe dy shtetasve të tjerë në vitin 1995. Mendohej se jetonte në Mbretërinë e Bashkuar me emër të rremë dhe se kishte aplikuar për azil. Prokuroria kërkoi ekstradimin. Gjykimi dhe kërkesa për ekstradim mbetën pezull deri në fund të vitit.

c. Tortura dhe Trajtime apo Ndëshkrime të Tjera Mizore, Çnjerëzore apo Poshtëruese Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë veprime të tilla; megjithatë, policia dhe rojet e burgjeve hera-herës rrahën dhe abuzuan të dyshuarit dhe të ndaluarit.

Gjatë vitit qeveria vazhdoi të zbatonte rekomandimet e dala nga vizita e Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT) i Këshillit të Europës në burgjet dhe qendrat e paraburgimit në vend në vitin 2008. CPT raportoi pretendime të besueshme keqtrajtimi fizik, shpesh të rëndë, veçanërisht gjatë marrjes në pyetje nga policia.

Raporti i KiE-s i 12 dhjetorit mbi trajtimin çnjerëzor dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore (shiko seksioni 1.a.) deklaroi se nga viti 1998 deri në qershor të vitit 1999, UÇK-ja në

bashkëpunim me SHIK-un, ndalonin “të burgosur luftime” nga Kosova në vende si Durrës, Cahan dhe Kukës ku mbaheshin në qeli të improvizuara, të lënë në mungesë të kushteve higjienike, pa ushqim dhe ujë dhe vizitoheshin rregullisht nga ushtarë të UÇK-së për t’u marrë në pyetje nën trajtim të ashpër dhe të rrahur pa dallim.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) dhe Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut (GShDNj) raportuan se policia hera-herës kishte përdorur forcë të tepërt apo trajtim çnjerëzor. Gjatë vitit, KShH raportoi se kishte marrë 10 ankesa për keqtrajtim nga policia dhe personeli i burgjeve. Shumica e këtyre ankesave kishin të bënin me ndalime të pajustificuara nga policia, mbajtje në paraburgim përtej afateve ligjore, mosnjohim i shtetasve për të drejtat e tyre gjatë ndalimit, dhe kushtet e këqija në qendrat e paraburgimit. KShH raportoi se kushtet dhe trajtimi gjatë mbajtjes nga policia janë më problematike se sa ato në sistemin e burgjeve. Sipas GShDNj, policia më shpesh i keqtrajtonte të dyshuarit në kohën e arrestimit apo të ndalimit fillestar. Romët, egjiptianët ballkanas, dhe personat e përfshirë në sjellje homoseksuale ishin veçanërisht të preکشëm nga abuzimi i policisë.

Policia hera-herës përdorte kërcënime dhe dhunë për të nxjerrë dëshmi.

#### Kushtet në Burgje dhe Qendrat e Paraburgimit

Ministria e Drejtësisë administronte të gjitha mjediset e paraburgimit, ndërsa Ministria e Brendshme mbikqyrte mjediset e ndalimit nga policia.

Kushtet e burgjeve kishin ndryshim të madh ndërmjet burgjeve që vinin nga periudha komuniste dhe ato të burgjeve të hapur pas vitit 1991. Në lidhje me burgjet nga periudha e komunizmit, shqetësimet lidheshin me mundësi të papërshtatshme për higjenë, ajrosje, ndriçim, kujdes për shëndetin dhe mundësi për ujë të pijshëm. Qeveria po merrte masa për të marrë parasysh këto nevoja duke nxjerrë gradualisht jashtë përdorimit objektet e vjetra. Burgjet e hapur pas vitit 1991 përgjithësisht përmbushnin standardet ndërkombëtare. Ndryshimet e ligjit në përcaktimin e sistemit të lirisë me kusht, përdorimi i direktivave për dënime alternative dhe ndërtimi i burgjeve të reja ulën mbipopullimin në burgje. KShH raportoi gjatë vitit se kishte zbutje të përgjithshme të mbipopullimit të burgjeve, gjerësisht si rezultat i shërbimeve të lirimit me kusht. Burgjet kanë marrë pajisje moderne mjekësore si edhe staf e furnizime mjekësore shtesë. Megjithatë, kujdesi për shëndetin nuk ishte gjithmonë i ndorshëm. KShH pa se gjatë vitit kushtet e infrastrukturës në disa prej qendrave të paraburgimit të policisë ishin shumë problematike.

Të burgosurit dhe të paraburgosurit kanë të drejtën të takojnë të afërmit dhe këto takime mund të jenë deri në katër herë në muaj për të rriturit dhe deri në tetë herë për të miturit. Të burgosurit dhe të paraburgosurit janë të lirë të ushtrojnë besimin e tyre fetar dhe disa njësi kanë vende të veçanta për shërbime fetare.

Të burgosurit dhe të paraburgosurit lejohen të dorëzojnë ankesa te Avokati i Popullit. Çdo ndërtesë ku vuhet dënimi ka kuti postare në të cilën të burgosurit dhe paraburgosurit kanë të drejtë të dorëzojnë ankesa, pa u censuruar. Avokati i Popullit raportoi se ky shërbim ishte funksional. Të burgosurit dhe paraburgosurit kanë gjithashtu të drejtë sipas ligjit që të bëjnë ankesa edhe te autoritetet gjyqësore dhe administrative.

Autoritetet hetuan deklaratat e besueshme në lidhje me kushte çnjerëzore dhe dokumentuan

rezultatet e këtyre hetimeve, megjithëse rezultatet nuk ishin gjithmonë lehtësisht të arritshme për publikun e gjerë. Sipas qeverisë, në vitin 2009 qeveria kreu 350 inspektime dhe hetime.

Qeveria lejoi grupe vendase dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, median dhe organizma të tjerë të monitoronin kushtet e burgjeve. Ligji parashikon që Avokati i Popullit të zbatojë Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Avokati i Popullit monitoroi gjithashtu kushtet e burgjeve dhe veprimet në lidhje me ankesat e të burgosurve. Avokati i Popullit pa se shumë njësi kishin mangësi në infrastrukturën e përshtatshme dhe gjeti raste mbipopullimi. Avokati i Popullit hetoi deklarata për korrupsion brenda sistemit të burgjeve dhe pa se korrupsioni ishte problem i rëndë. Megjithatë, mandati i Avokatit të Popullit mbaroi në mars, dhe parlamenti nuk mundi të emëronte një të ri, duke krijuar një boshllëk që pengoi funksionimin e kësaj zyre.

Nuk pati raportime gjatë vitit për mbajtjen e të miturve së bashku me të rriturit. Në tetor të vitit 2009 qeveria hapi Institutin për të Mitur në Kavajë, i cili shërben si qendër rehabilitimi, korrigjimi dhe konsultimi për të mitur.

Në vitin 2009 autoritetet nisën 361 procedime disiplinore kundër rojeve dhe zyrtarëve të burgut.

#### d. Arrestimi ose Ndalimi Arbitrar

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin ose ndalimin arbitrar; megjithatë, pati disa raportime se policia në disa raste arrestoi dhe ndaloi persona në mënyrë arbitrare.

#### Roli i Policisë dhe Aparatit të Sigurisë

Njësitë vendore të policisë raportojnë tek Ministria e Brendshme dhe janë forca kryesore përgjegjëse për sigurinë e brendshme.

Pavarësisht përmirësimeve në trajnimin dhe menaxhimin e zbatimit të ligjit, policia nuk i respektoi rregullisht të drejtat e njeriut gjatë kryerjes së detyrës për shtetasit dhe nuk ishte tërësisht përgjegjëse për rendin. Në disa raste përbënte problem mosndëshkimi i policisë. Oficerët e policisë nuk e zbatuan ligjin në mënyrë të barabartë dhe lidhjet politike e kriminale të personit shpesh ndikonin në zbatimin e ligjeve. Sjellja joprofesionale dhe korrupsioni, së bashku me pagat e ulëta, mbetën pengesa madhore për zhvillimin e një force policore civile të efektshme.

Gjatë vitit, avokati i popullit përpunoi dhe përfundoi ankesa kundër punonjësve të policisë kryesisht për çështje të lidhura me arrestimin dhe ndalimin; avokati zgjidhi afërsisht një të tretën në favor të shtetasit që kishte paraqitur ankesën.

#### Procedurat e Arrestimit dhe Trajtimi Gjatë Ndalimit

Kushtetuta kërkon që autoritetet të informojnë personat e ndaluar menjëherë për akuzat kundër tyre dhe të drejtat e tyre. Policia në disa raste nuk informoi shtetasit në lidhje me të drejtat e tyre në kohën e arrestimit. Sipas ligjit, policia duhet të informojë menjëherë prokurorin për një arrestim. Prokurori mund ta lirojë të dyshuarin ose t'i drejtohet gjykatës brenda 48 orëve për ta mbajtur personin më gjatë. Gjykata duhet të vendosë brenda 48 orëve nëse një shtetas duhet mbajtur në paraburgim, të kërkojë garanci, të ndalojë udhëtimin, apo të kërkojë që i pandehuri të

paraqitet rregullisht në polici. Në praktikë, prokurorët kërkonin ndalimin dhe gjykatat urdhëronin ndalimin në mënyrë rutinë në shumë raste penale. Megjithatë gjykatat mohuan në mënyrë rutinë kërkesat e prokurorëve për ndalimin e të pandehurve me lidhje të forta dhe me pozitë. Në shumë raste u dha arresti në kushtet e shtëpisë, por nuk u zbatua si duhet. Koha e kaluar në arrest shtëpie i shtohet kohës së burgut nëse një i pandehur kishte marrë dënimin.

Gjykatat duhet t'u ofrojnë të pandehurve të varfër këshillim ligjor falas. Sipas KShH, policia shpesh nuk i informonte të pandehurit për këtë të drejtë dhe pati ankesa nga të ndaluarit se autoritetet nuk u dhanë atyre këshillim mbrojtjeje që nga fillimi i arrestit. KShH dhe një numër OJQ-sh të tjera ofruan këshillim ligjor falas dhe shërbime avokatie për personat e varfër.

Ligji kërkon përfundimin e shumicës së hetimeve para gjyqit brenda tre muajve, megjithatë, prokurori mund ta zgjasë këtë periudhë deri në dy vjet ose më gjatë. Sipas ligjit ndalimi maksimal në paraburgim nuk duhet të kalojë tre vjet; nuk pati raportime gjatë vitit për shkeljen e këtij kufiri. Megjithatë, ndalimet e stërzgjatura në paraburgim shpesh ndodhnin për shkak të hetimeve të vonuara, gabimeve në mbrojtje, apo mosparaqitjes së qëllimtë të avokatëve mbrojtës. Për shembull, në rastin e Gërdecit në vitin 2008, rast që ka të bëjë me shpërthimin e një ish reparti ushtarak për demontimin e municionioneve që çoi në 26 të vdekur. Seancat dëgjimore u shtynë 77 herë gjatë vitit, në shumë raste si rezultat i mosparaqitjes së avokatëve mbrojtës ose si rezultat i mungesës së një prej anëtarëve të gjykatës. Sipas ligjit, gjykatësi nuk mund ta ndalojë avokatin nga mosparaqitja në gjyq në mënyrë që të mund të shmangeshin këto veprime nga ana e avokatëve.

Burimet e kufizuara materiale, mungesa e hapësirës, administrimi i keq i kalendarit të gjykatës, personeli i pamjaftueshëm si edhe mosparaqitja e avokatëve dhe dëshmitarëve nuk lejonin sistemin e gjykatave që t'i gjykonin çështjet në kohë.

#### e. Mohimi i Gjyqit të Drejtë Publik

Kushtetuta siguron gjyqësor të pavarur; megjithatë, presioni politik, kanosja, korrupsioni i përhapur gjerësisht dhe burimet e kufizuara hera-herës nuk e lejonin gjyqësorin që të funksiononte në mënyrë të pavarur dhe efikase. Politizimi i emërimeve në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese kërcënojnë të dëmtojnë pavarësinë dhe integritetin e këtyre gjykatave.

#### Procedurat Gjyqësore

Ligji siguron të drejtën për gjykim të paanshëm ku të pandehurit prezumohen të pafajshëm deri sa të dënohen. Sistemi i gjykatave nuk siguron gjykimet me juri. Prokurorët dhe avokatët mbrojtës ia paraqesin argumentat një gjyqtari apo paneli gjyqtarësh. Të pandehurit kanë të drejtë të kenë akses ndaj të gjitha fakteve që prokurorët i paraqesin gjyqtarëve, kanë të drejtë të marrin në pyetje dëshmitarët kundër tyre dhe të paraqesin dëshmitarë dhe prova. Të pandehurit kanë të drejtën e apelit. Ligji mandaton sistem dënimi alternativ për të miturit.

#### Të Burgosur dhe Të Ndaluar Politikë

Nuk pati raportime për të burgosur apo të ndaluar politikë; megjithatë, ish të burgosurit politikë

gjatë qeverisjes komuniste u ankuan për mosmarrjen e kompensimit që u takonte sipas ligjit, ose për kryerjen shumë të ngadaltë të pagesave.

#### Vendimet e Gjykatave Rajonale të Drejtave të Njeriut

Gjykata Europiane e Drejtave të Njeriut nxorri tetë gjykime në lidhje me vendin gjatë vitit. Këto çështje në masë të gjerë kishin të bënin me të drejtën për gjykim të paanshëm brenda një kohe të arsyeshme, të drejtën për zhdëmtim real, dhe të drejtën për të gëzuar qetësisht pronat. Deri në shtator, 287 çështje në lidhje me Shqipërinë prisnin gjykimin nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut.

#### Procedurat Gjyqësore Civile dhe Ankimet

Ekziston një sistem funksional i së drejtës civile ku shtetasit kanë të drejtën e ankimimit; megjithatë, ky sistem ishte i prekshëm nga korrupsioni, paaftësia dhe ndërhyrjet politike. Këta faktorë dëmtojnë autoritetin e gjyqësorit, çojnë në vendime gjyqësore të diskutueshme dhe në zbatim me mospërputhje të Kodit Civil. Zyra e Përmbarrimit është përgjegjëse për ekzekutimin e gjykimeve civile. Ligji lejon përmbarruesit privatë që të ekzekutojnë gjykimet, duke lehtësuar si entet publike ashtu edhe ato private që të ndihmojnë ekzekutimin e vendimeve. Megjithatë, nuk u realizua zbatimi i plotë dhe në kohë i vendimeve të gjyqit.

#### Kthimi i Pronave

Ligjet që rregullojnë kthimin ose kompensimin e pronave private apo fetare të konfiskuara gjatë kohës së komunizmit janë të ndërlikuara dhe një numër i madh çështjesh që kanë të bëjnë me pretendimet kundërshtuese nga pronarët e rinj dhe shtetit (nga njëra anë) dhe pronarëve të mëparshëm (nga ana tjetër) mbetën të pazgjidhura. Nuk pati përditësim në lidhje me dokumentin informues të Parlamentit Europian në vitin 2008 mbi kthimin e pronave në vend, i cili vërejtë se raundi i parë i gjykimeve nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut kishte konstatuar “mangësi serioze” në sistemin administrativ dhe gjyqësor të vendit për sa i përket kthimit dhe kompensimit të pronave pronarëve të mëparshëm. Gjyqësori ka probleme të rënda me pavarësinë, transparencën dhe besueshmërinë.

Ashtu si në vitet e mëparshme, qeveria nuk dha kthim apo kompensim për organizatat fetare me prona dhe objekte fetare që kishin qenë konfiskuar apo dëmtuar gjatë regjimit komunist.

#### f. Ndërhyrja Arbitrare në Privatësi, Familje, Shtëpi apo Korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë veprime të tilla dhe qeveria përgjithësisht i respektoi ato në praktikë.

#### Seksioni 2 Respekti për Liritë Civile, Përfshirë:

##### a. Liria e Fjalës dhe Shtypit

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e fjalës dhe të shtypit. Ndërkohë që qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta, pati raportime që pohonin se qeveria dhe bizneset ushtruan presion të tërthortë mbi median.

Në përgjithësi, individët mund ta kritikonin qeverinë publikisht ose privatisht pa u ndëshkuar, megjithëse pati disa përjashtime. Disa kompani mediatike raportuan se kishin patur kontrolle mbi taksat për shkak të këndvështrimit të tyre editorial. Dy gazeta ditore (Tema dhe Korrieri) u

mbyllën në pranverë pasi morrën gjoba përkatësisht prej 20 dhe 22 milionë lekësh (200 000 dhe 220 000 dollarë). Këto të përditshme deklaruan se qeveria i gjobiti për shkak të mungesës së dokumentacionit që të vërtetonte se i kishin shkatërruar kopjet e pashitura. Tema pohoi se kontrolli shkoi deri të dhënat e vitit 2005. Tema e apeloj gjobën në Ministrinë e Financës dhe kjo çështje vazhdoi. Në tetor Tema rinisi botimin pas një riorganizimi.

Media ishte aktive dhe në masë të gjerë e pakufizuar; megjithatë, pati raste presioni politik të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë mbi median, përfshirë kërcënime ndaj gazetarëve. Në disa raste presioni politik dhe mungesa e fondeve kufizuan median e shkruar nga pavarësia, dhe gazetarët raportuan se kishin përjetuar vetëcensurë të gjerë. Partitë politike, sindikatat dhe grupe të tjera botuan gazeta ose revista në pavarësi nga ndikimi i qeverisë.

Radio dhe Televizioni Publik Shqiptar administronte një kanal kombëtar televiziv dhe një stacion kombëtar radio. Me ligj ai merr 50 përqind të buxhetit nga qeveria. Stacioni mbeti nën kontroll nga qeveria në linjën e vetë editoriale. Edhe pse stacionet private në përgjithësi kanë vepruar të lirë nga ndikimi i drejtpërdrejtë i qeverisë, shumica e pronarëve besonin se përmbajtja e materialeve të shfaqura prej tyre mund të ndikonte veprimet e qeverisë kundrejt bizneseve të tjera që ata zotëronin. Pronarët e biznesit gjithashtu përdornin median lirshëm për të fituar favore dhe për të nxitur interesat e tyre me të dyja partitë kryesore politike.

Roli investigativ i medias vazhdoi gjatë këtij viti. Programi satirik investigativ, Fiks Fare, i kanalit kryesues Top Channel, çoi në pushime nga puna dhe ndjekje penale kundër zyrtarëve publikë të korruptuar. Në vitin 2009, një filmim me kamera të fshehtë çoi në shkarkimin e ish ministrit të kulturës, rinisë dhe sporteve, Ylli Pango, i cili akuzohej për sjellje të pahijshme seksuale. Në 18 qershor Gjykata e Rrethit të Tiranës dëgjoi padinë e Ylli Pangos dhe vendosi të gjobiste kanal televiziv me 51 milionë lekë (500 000 dollarë) për “dëmtim të imazhit moral të ish ministrit dhe shkaktim ankthi e brengje.” Stacioni televiziv e apeloj vendimin dhe çështja mbeti pezull deri në fund të vitit.

Në mars gjykata e apelit modifikoi vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 2006 për të ndaluar qeradhënien e hapësirës së Top Channel për 20 vjet. Top Channel është një stacion televiziv privat, hera-herës kritik ndaj qeverisë. Ky stacion u urdhërua të lëshonte ndërtesën shtetërore ku ndodhej. Këshilli ra dakord të lejonte Top Channel të lëvizte në një pronë tjetër shtetërore. Pavarësisht këtij vendimi, stacioni televiziv pohoi se qiramarrësit në pronën e re nuk e lejuan Top Channel të transferohej dhe të vazhdonte punën atje. Në mars, Gjykata e Apelit e ktheu çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Çështja ishte në vazhdim deri në fund të vitit.

Ligji e ndëshkon shpifjen me dënim me burg deri në dy vjet dhe gjobë. Gjatë vitit, nuk pati padi për shpifje kundër gazetarëve. Megjithatë, dy organizata të medias, Vizion Plus dhe Shekulli, në dhjetor bënë padi për shpifje kundër kryeministrit për deklarata publike paragjyquese kundër tyre në parlament. Gjykata e Lartë mori vendimin në maj dhe qershor, duke cituar se “nuk kishte elemente për shkeljen penale të ofendimit dhe shpifjes sepse palët e dëmtuara nuk mund t'i provonin akuzat.”

Vazhduan forma të ndryshme të kanosjes ndaj medias. Gazetarët vazhduan të ankoheshin se

botuesit dhe redaktorët censuronin punën e tyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi në përgjigje të presioneve politike apo të biznesit. Shumë gazetarë u ankuan se mungesa e kontratave të punës për ta shpesh pengonte mundësinë e tyre për të raportuar në mënyrë objektive.

Në 14 nëntor u raportua se një korrespondent për Gjirokastrën i gazetës së përditshme Panorama u sulmua nga dy persona. U tha se sulmuesit i kërkuan reporterit të mos shkruante më në gazetë. Përpara sulmit, reproteri kishte botuar një intervistë me një grua në anonimat, e cila sipas shkrimit punonte në plantacionet e drogës në Lazarat. Reporterit depozitoi padi penale në Prokurori. Çështja ishte në vazhdim deri në fund të vitit.

Në dhjetor biznesmeni Rezart Taçi - i cili akuzohej për sulm ndaj gazetarit Mero Baze në nëntor të vitit 2009 për raportin e Bazes mbi akuza korrupsioni në privatizimin e ARMO-s, rafineria shtetërore e naftës në vend - doli i pafajshëm. Dy truporjat e tij u gjobitën me 350 000 lekë secili (3 500 dollarë).

### Liria e Internetit

Nuk pati kufizime nga qeveria mbi aksesin ndaj internetit apo raportime që qeveria të kishte monitoruar postën elektronike ose dhomat e diskutimit në internet. Individët dhe grupet mund të përfshiheshin në diskutime paqësore të pikëpamjeve në internet, përfshi edhe me postë elektronike. Aksesin ndaj internetit u rrit me shpejtësi gjatë vitit, por mbeti i kufizuar, sidomos jashtë qendrave kryesore urbane. Sipas statistikave të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit për këtë vit, rreth 36 përqind e banorëve të vendit përdornin internetin krahasuar me 20.6 përqind në vitin 2009. Nga këta përdorues, 80 përqind ishin përdorues interneti nëpërmjet telefonave celularë.

Ligji parashikon që Zyra e Komisionerit për Ruajtjen e të Dhënave të shqyrtojë ankesat në lidhje me abuzimin apo keqpërdorimin e informacionit personal në Internet. Gjatë këtij viti nuk pati raportime për përpjekje nga qeveria që të mblidhte informacion të identifikueshëm mbi një person në lidhje me shprehjen paqësore nga ana e këtij të fundit e mendimit ideologjik, fetar apo politik.

### Liria Akademike dhe Veprimtaritë Kulturore

Nuk pati kufizime nga qeveria të lirisë akademike apo aktiviteteve kulturore.

#### b. Liria e Grumbullimit Paqësor dhe Shoqatave

##### Liria për tu grumbulluar

Kushtetuta dhe ligji sigurojnë lirinë e grumbullimit dhe shoqatave dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta në praktikë.

Ligji u kërkon organizatorëve të tubimeve në vende publike që të njoftojnë policinë tri ditë përpara; nuk pati raportime që policia të ketë mohuar të tilla tubime arbitrarisht.

##### Liria e Shoqatave



Kushtetuta siguron lirinë e shoqatave dhe qeveria në përgjithësi e respektoi këtë në praktikë. Ligji ndalon formimin e partive ose organizatave politike që nuk janë transparente ose janë të fshehta; nuk ka raportime të përdorimit nga ana e qeverisë të kësaj dispozite kundër ndonjë grupi gjatë vitit.

#### c. Liria e Besimit Fetar

Për të parë përshkrimin e plotë të lirisë së besimit fetar, shikoni Raportin Ndërkombëtar për Lirinë e Besimit Fetar për Vitin 2010 në adresën [www.state.gov/g/drl/irf/rpt/](http://www.state.gov/g/drl/irf/rpt/).

#### d. Liria e Lëvizjes, Personat e Zhvendosur në Vend, Mbrojtja e Refugjatëve dhe Personat pa Shtetësi

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e lëvizjes në vend, udhëtimin jashtë vendit, emigracionin dhe riatdhesimin; qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta në praktikë. Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisionerit të Lartë për Refugjatët (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për të ofruar mbrojtje dhe ndihmë për personat e zhvendosur brenda vendit, refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, personat pa shtet dhe persona të tjerë që përbënin shtetësim.

Migruesit e brendshëm duhet të transferojnë regjistrimin e tyre civil në vendin e ri të banimit për të përfituar shërbimet e qeverisë dhe duhet të provojnë se janë ligjrisht banorë me anë të vërtetimit të pronës, një marrëveshje qeraje për përdorim prone, apo faturat e shërbimeve të përditshme. Shumë persona nuk mund të siguronin prova të tilla dhe kështu nuk kishin akses ndaj shërbimeve bazë. Shtetasve të tjerë u mungonte regjistrimi formal në bashkësitë ku banonin, sidomos romët dhe egjiptianët ballkanas. Ligji nuk e ndalon regjistrimin e tyre por shpesh ishte e vështirë të realizohej kjo gjë në praktikë.

Ligji ndalon mërgimin e detyruar dhe qeveria nuk e përdori atë.

#### Mbrojtja e Refugjatëve

Ligjet e vendit sigurojnë dhënien e azilit ose statusit të refugjatit dhe qeveria ka ndërtuar një sistem për t'u siguruar mbrojtje refugjatëve.

Në praktikë, qeveria ofroi mbrojtje ndaj dëbimit apo kthimit të refugjatëve në vendet ku jetët apo liria e tyre do të kërcënoheshin mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup shoqëror, apo mendimit politik. Sipas ligjit, nuk ka kufi kohor për kërkesën për azil, por qeveria duhet të marrë vendimin në lidhje me dhënien e azilit brenda 101 ditësh nga kërkesa fillestare. Në përgjithësi qeveria iu përmbajt kësaj kornize kohore. Qeveria bashkëpunoi në mënyrë aktive me UNHCR dhe Shërbimet për Migrantë dhe Refugjatë në Shqipëri, të cilat dhanë ndihmë për refugjatët.

Qeveria u dha mbrojtje të përkohëshme refugjatëve, e cila gjatë vitit arriti në 99 persona.

Në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare, me anë të programit të BE-së për Asistencë të Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim, qeveria kontrolloi migrantët pa dokumenta në të gjitha pikat e kalimit të kufirit. Sipas programit, një OJQ dhe një ekip i qeverisë ndihmuan

policinë e kufirit që të identifikonte migrantët pa dokumenta, të cilët ishin viktima të mundshme të trafikimit, azilkërkuesit, apo migrantët ekonomikë.

### Seksioni 3

Respekti për të Drejtat Politike: E Drejta e Shtetasve për të Ndryshuar Qeverinë e Tyre

Kushtetuta dhe ligji u garantojnë shtetasve të drejtën të ndryshojnë qeverinë e tyre në mënyrë paqësore dhe shtetasit e ushtruan këtë të drejtë në praktikë me anë të zgjedhjeve periodike bazuar mbi të drejtën universale të votës.

### Zgjedhjet dhe Pjesëmarrja Politike

Në qershor të vitit 2009 vendi zhvilloi zgjedhjet parlamentare për të cilat misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE ODIHR deklaroi se përmbushën pjesën më të madhe të angazhimeve të OSBE-së. Megjithatë, ato “nuk realizuan plotësisht potencialin e vendit për t’iu përmbajtur standardeve më të larta për zgjedhje demokratike.” Misioni i vëzhgimit citoi në mënyrë të veçantë probleme në procedurat administrative me numërimin e votave, “një mjedis tejet të polarizuar”, mbulim të njëanshëm mediatik dhe shkelje procedurale, si votime me prokurim. Vëzhguesit e ODIHR i vlerësuan votimet pozitivisht në 92 përqind të qendrave të votimit.

Procesi sipas të cilit partitë politike emërojnë komisionerët e votimeve mbetet i paqartësuar. Sipas ligjit, partitë politike duhet të emërojnë komisionerët e zgjedhjeve 45 deri në 90 ditë përpara zgjedhjeve, në varësi të rolit të tyre. Megjithatë, partitë politike nuk e ndoqën ligjin në praktikë gjatë gjithë kohës. Si rezultat, partitë politike shpesh ndryshuan komisionerët ose nuk i emëruan ata deri shumë pak para zgjedhjeve, duke mos u dhënë mundësinë kështu të merrnin trajnimin e duhur për të kryer me sukses detyrën e tyre. Komisionerët e zgjedhjeve ishin gjithashtu të prekshëm nga ndërhyrjet prej partive politike.

Deri në mbyllje të vitit vazhdoi gjendja e situatës pa zgjidhje që pasoi zgjedhjet e qershorit të vitit 2009. PS-ja, edhe pse i kishte certifikuar rezultatet e zgjedhjeve, bojkotoi parlamentin, bëri thirrje për hetime mbi akuzat për mashtrim elektoral dhe bllokoi legjislacione kyçe që kërkonin shumicë të plotë parlamentare, përfshirë edhe krijimin e një sistemi gjykatash administrative. Puna e parlamentit u pengua nga gjendja pa rrugëdalje e situatës politike, dhe as PS-ja as qeveria nuk treguan gatishmëri për kompromis dhe për përfundimin e kësaj situatë pa rrugëdalje. Si rezultat, parlamenti nuk funksionoi plotësisht gjatë vitit, dhe nuk aprovoi thuajse asnjë propozim legjislativ madhor.

Partitë politike vepruan pa kufizime apo ndërhyrje të jashtme. Vendi ka dy parti politike kryesore, Partia Demokratike (PD) dhe Partia Socialiste (PS) si edhe shumë parti të vogla. Në zgjedhjet e qershorit të vitit 2009, 34 parti bënë fushatë lirshëm në gjithë vendin. Financimi i partive politike ishte në masë të gjerë i paqartë.

Në tërësi, femrat ishin të keqpërfaqësuar në nivelet kombëtare dhe vendore të qeverisjes, pavarësisht angazhimeve nga partitë kryesore për të rritur përfaqësimin e tyre. Pas zgjedhjeve të qershorit të vitit 2009, kishte 23 femra në parlamentin me 140 vende, një rritje prej nëntë vendesh nga parlamenti i mëparshëm. Këto përfshinin kryetaren e parlamentit dhe një femër në

Këshillin e Ministrave.

Ligji kërkon që femrat të zënë 30 përqind të posteve të emëruara e zgjedhura dhe kodi zgjedhor parashikon që 30 përqind e kandidatëve duhet të jenë femra. Megjithatë, jo të gjitha partitë e zbatuan kodin zgjedhor dhe shumë i vendosën emrat e femrave në fund të fletëve të votimit, duke u siguruar praktikisht që ato nuk do të fitonin vend në parlament sipas sistemit parlamentar proporcional rajonal të vendit në të cilin votat u caktohen kandidatëve sipas radhës së paraqitjes së tyre në fletën e votimit.

Një numër anëtarësh të pakicës greke shërbyen në parlament dhe në degën ekzekutive në poste ministrore dhe nënministrore, përfshirë edhe postin e ministrit të punës.

#### Seksioni 4 Korrupsioni Zyrtar dhe Transparenca e Qeverisë

Ligji parashikon ndëshkime penale për korrupsionin zyrtar; megjithatë, pavarësisht një numri arrestimesh të zyrtarëve të lartë të qeverisë qendrore dhe vendore, korrupsioni qeveritar mbeti pengesë madhore për reformat domethënëse. Indekset e Bankës Botërore për qeverisjen për vitin 2009 tregonin se korrupsioni ishte problem serioz. Sipas një sondazhi për korrupsionin të bërë gjatë vitit, 91.8 përqind e personave që janë përgjigjur mendojnë se korrupsioni i punonjësve të administratës publike ishte ose “i përhapur” ose “disi i përhapur.” Personat që iu përgjigjën sondazhit pohuan se zyrtarët e doganës dhe të zyrës së taksave, si edhe doktorët, përbënin institucionet dhe grupet më të korruptuar.

Qeveria ndoqi penalisht zyrtarë të korruptuar dhe shqyrtoi ankesa në lidhje me policë të korruptuar nëpërmjet Avokatit të Popullit dhe Shërbimit të Kontrollit për Policinë e Shtetit Shqiptar. Megjithatë, dhënia e imunitetit në masë të gjerë për gjykatës, anëtarë parlamenti dhe zyrtarë të tjerë të lartë u bë pengesë për mundësitë e qeverisë për të ndjekur penalisht korrupsionin në nivele të larta. Imuniteti mund të hiqet vetëm nga parlamenti ose me vendim të Këshillit të Lartë për Drejtësi. Taskforca e qeverisë kundër krimit të organizuar bashkërendoi veprimet kundër korrupsionit. Taskforca, e drejtuar nga kryeministri, përbëhej nga disa ministra dhe drejtues të agjencive të pavaruara shtetërore, si kompania energjitike shtetërore dhe përfaqësues të policisë dhe organizatave të inteligjencës.

Ligji ua ndalon ministrave të qeverisë dhe anëtarëve të afërt të familjes së tyre të zotërojnë kompani të lidhura drejtpërdrejt me përgjegjësitë e tyre zyrtare. Qysh nga formimi në vitin 2003, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë (ILDKP) mori deklarata pasurie nga zyrtarë. ILDKP-ja ka përgjegjësinë të zbatojë ligjin e deklarimit të pasurive dhe ligjin e konfliktit të interesit. ILDKP-ja mbledh çdo vit afro 4000 formularë të deklarimit të pasurisë nga politikanë, punonjës të shërbimit publik dhe nga gjyqësori. Për të bërë një hetim të plotë administrativ, ILDKP-ja zgjodhi rastësisht 4 përqind. Gjithashtu, ILDKP-ja hetoi çështje të referuara nga media, shoqëria civile dhe të tjerë. Mandati i ILDKP-së është i kufizuar në kryerjen e hetimeve administrative dhe në referimin e çështjeve në prokurori për hetime të mëtejshme. Gjatë vitit ILDKP-ja dërgoi 14 çështje në prokurori për hetime të mëtejshme dhe ndihmoi në zgjidhjen e 197 çështjeve me konflikt interesi. Pati shumë zyrtarë që deklaruan pasuritë e tyre për herë të parë gjatë vitit. ILDKP-ja administron rregulloren e konfliktit të interesit; gjatë vitit ky institucion gjobiti persona për vonesë në dorëzim e gjobiti 29 persona për konflikt interesi. Ministria e Brendshme raportoi gjatë vitit se policia e shtetit hetoi 1931 raste të lidhura me

korrupsionin dhe krimet financiare, dhe autoritetet arrestuan 359 persona. Qeveria konfiskoi afërsisht 835 milionë lekë (8 milionë dollarë) në pronë. Sipas Ministrisë së Brendshme, policia shpërbëi grupe të organizuara kriminale gjatë vitit. Megjithatë, krimi i organizuar mbetet problem i rëndë.

Njësia e Përbashkët Hetimore për Luftën Kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit (NjPH) hetoi dhe ndoqi penalisht korrupsionin publik dhe krime të tjera financiare. Janë shtatë NjPH (një në Tiranë dhe gjashtë të tjera të shpërndara në gjithë vendin), të cilat hetojnë korrupsionin dhe krimet e tjera financiare. Dy gjykatës u rekomanduan nga shtetas, të cilëve zyrtarët u kishin kërkuar rryshfete për të marrë vendime favorizuese. NjPH-të akuzuan gjithashtu dy prokurorë për korrupsion duke pranuar rryshfete në lidhje me çështje penale. Të gjitha këto çështje ishin pezull deri në fund të vitit.

NjPH-të përbëheshin nga staf policie nga prokuroria, policia e shtetit, policia doganore dhe e taksave e nga institucione të tjera të lidhura me të. NjPH-të përdorën strukturë pune në skuadër për të përqendruar aftësitë dhe nxitur komunikimin e nevojshëm për hetime dhe ndjekje penale të suksesshme. NjPH-të merrnin rekomandime nga shtetasit.

NjPH-të vazhduan të sillnin çështje në disa sektorë ku korrupsioni lulëzonte. Në fushën e mjekësisë, zyrtarët ngritën akuza për korrupsion ndaj disa kirurgëve, anestezistëve dhe anëtarëve të tjerë të personelit mjekësor; këta kërkonin pagesë për të dhënë shërbime që duhet të jepeshin falas nga qeveria. Zyrtarët arrestuan oficerë të policisë rrugore në disa prej qyteteve të mëdha me akuza për korrupsion dhe abuzim me detyrën duke pranuar rryshfete në vend të gjobave për kundravajtje rrugore. Prokurorët akuzuan zyrtarë dogane dhe biznesmenë për korrupsion dhe kontrabandë; ata lejonin kamionët të kalonin kufirin pa paguar detyrimet doganore.

Pas një hetimi prej tetë muajsh në lidhje me korrupsionin në importin e karburantit, në 3 qershor autoritetet arrestuan drejtorin dhe dy inspektorë nga Drejtoria e Kontrollit të Karburanteve në Ministrinë e Ekonomisë. Këta tre zyrtarë morrën 100 000 dollarë rryshfet (10 000 dollarë për çdo anije që kalonin) për një periudhë prej tetë muajsh nga një improtues karburanti për lëshimin e lejeve fallco të inspektimit teknik dhe lejeve doganore fallco.

Në fillim të vitit 2009 u bë gjykimi i disa ish zyrtarëve të qeverisë, përfshirë dhe ish kreun e Komisionit të Kthimit të Pronave dhe avokatin e tij, mbi akuza për korrupsion, abuzim me detyrën dhe fallcifikim dokumentash. Prokurorët pretendonin se të dy këta persona drejtonin një skemë për dhënie të rreth 55 hektarëve tokë bregdetare ajkë një familjeje që nuk kishte pasur anjëherë e nuk kishte pretenduar të kishte tokë. Për shkak të shumë vonesave, përfshirë dhe mungesën e avokatit mbrojtës në disa raste, gjykimi vazhdoi deri në fund të vitit.

Prokurorja e Përgjithshme nuk bëri kërkesa të tjera gjatë vitit për të hequr imunitetin zyrtar të ish ministrit të mbrojtjes Fatmir Mediu në lidhje me shpërthimin e vitit 2008 në një bazë ushtarake ku municioni i vjetër shndërrohej në të sigurt, në Gërdec. Në vitin 2009 Gjykata e Lartë mori vendimin se Mediu kishte imunitet zyrtar nga rizgjedhja e tij në parlament në qershor të vitit 2009.

Mungesa e një sistemi të shërbimit civil të pavarur, efikas dhe bazuar në meritë mbetet pengesë për luftën kundër korrupsionit dhe pengon në mundësitë e qeverisë për t'u shërbyer qytetarëve në

mënyrë të vlefshme dhe me transparencë. Politizimi i sistemit të punësimit të nëpunësve civilë çon në qarkullim të lartë të nëpunësve civilë.

Vazhdoi korrupsioni në sistemin arsimor. Zyrtarët e universitetit raportohet se kërkonin pagesa për praninë e studentëve. Kishte zyrtarë që kërkonin rryshfete ose favore seksuale nga studentët që këta të fundit të mund të pranoheshin në universitet ose të kalonin provimet.

Shtetasit dhe joshitetasit, përfshirë median e huaj, kanë të drejtën të marrin informacion lidhur me veprimtaritë e organeve qeveritare dhe personave që ushtrojnë funksione zyrtare shtetërore; megjithatë, shtetasit shpesh u përballën me probleme serioze në marrjen e informacionit nga institucionet publike dhe qeveritare.

Ligji kërkon që zyrtarët publikë të japin të gjithë informacionin dhe dokumentet zyrtare me përjashtim të dokumenteve të klasifikuara dhe sekreteve shtetërore. Shumica e ministrive dhe agjencive qeveritare afishonin informacionin publik drejtpërdrejt në faqet e tyre të internetit. Megjithatë, bizneset dhe shtetasit u ankuan për mungesë transparence dhe mospublikim të rregullores apo legjislacionit që duhet të ishte informacion publik bazë.

Seksioni 5 Qëndrimet e Qeverisë Lidhur me Hetimin Ndërkombëtar dhe Joqeveritar të Shkeljeve të Pretenduara të Të Drejtave të Njeriut

Një numër grupesh vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përgjithësisht funksionuan pa kufizime nga qeveria, duke hetuar dhe duke publikuar konstatimet e tyre mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Zyrtarët qeveritarë përgjithësisht bashkëpunuan dhe iu përgjigjën pikëpamjeve të tyre. Qeveria gjatë vitit krijoi një agjensi për mbështetjen e shoqërisë civile, e cila ka të drejtë të ndajë fonde shtetërore për OJQ-të. Në dhjetor të vitit 2009 një grup OJQ-sh të drejtave të njeriut bashkëpunuan për të botuar një raport mbi të drejtat e njeriut në vend dhe kanë në plan të nxjerrin një tjetër në vitin 2011.

Avokati i popullit është institucioni kryesor për të drejtat e njeriut që bën nxitjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit ka autoritetin të monitorojë procedurat gjyqësore dhe të inspektojë mjediset e paraburgimit dhe burgjet; avokati mund të fillojë çështje në të cilat një viktimë nuk ka vullnetin apo mundësinë të dalë publikisht. Megjithëse avokatit të popullit i mungonte fuqia për të siguruar zbatimin e vendimeve, ai vepronte si monitorues për shkeljet e të drejtave të njeriut. Çështjet më të zakonshme kishin të bënin me ankesa të shtetasve për abuzim me detyrën nga policia, mungesë të ekzekutimit të vendimeve të gjykatave në çështjet civile, shkarkime të padrejta nga puna dhe mosmarrëveshje për pronat. Avokati i Popullit i raporton parlamentit një herë në vit.

Në shumë raste qeveria ndërroi hapa konkrete për të korrigjuar probleme në përgjigje të konstatimeve të avokatit të popullit. U përmirësua bashkëpunimi midis Ministrisë së Brendshme dhe avokatit të popullit dhe qeveria vuri në zbatim disa sugjerime të bëra nga avokati i popullit.

Qeveria bashkëpunoi me OKB-në dhe organizma të tjera ndërkombëtare, duke lejuar vizita gjatë gjithë vitit.

Parlamenti ka një komision mbi Çështjet Ligjore, Administrimin Publik dhe të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, ky komision ka qene tejet joefikas në çështjet për të drejtat e njeriut dhe mbeti i ndrydhur në punën e tij prej bojkotit të parlamentit nga PS-ja.

## Seksioni 6 Diskriminimi, Abuzimi nga Shoqëria, dhe Trafikimi i Personave

Ligji ndalon diskriminimin e bazuar mbi racën, seksin, etninë, paaftësinë, gjuhën apo statusin shoqëror; megjithatë, qeveria nuk i vuri në zbatim efektshëm këto ndalime dhe pati vazhdimësi të diskriminimit. Në 4 shkurt parlamenti aprovoi një ligj të ri kundër diskriminimit. Ligji krijoi Zyrën e Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi, e cila do të marrë dhe përpunojë ankesat për diskriminim. Në maj parlamenti emëroi një komisioner; megjithatë, institucioni i ri pati mungesë fondesh dhe stafi të mjaftueshëm.

### Femrat

Kodi penal dënon përdhunimin, përfshi përdhunimin bashkëshortor; megjithatë, viktimat rrallë raportojnë abuzim bashkëshortor dhe zyrtarët nuk e ndiqnin penalisht përdhunimin bashkëshortor në praktikë. Koncepti i përdhunimit bashkëshortor nuk ishte i konsoliduar mirë; autoritetet dhe publiku shpesh nuk e konsideronin si krim. Ligji imponon dënime për përdhunimin dhe sulmet në varësi të moshës së viktimës. Për përdhunimin e një të rrituri, dënimi me burg është tre deri në 10 vjet; për përdhunim të një adoleshenti në moshat 14 deri 18 vjeç, dënimi është pesë deri në 15 vjet dhe, për përdhunim të një fëmije nën 14 vjeç, dënimi është shtatë deri në 15 vjet.

Dhuna në familje kundër gruas, përfshirë abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz. Gjatë vitit, policia raportoi raste të dhunës në familje dhe qeveria ngriti padi për këto çështje. Departamenti për shanse të barabarta në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta mbulon çështjet e femrave, përfshirë dhunën në familje. Qeveria nuk financoi programe të veçanta për të luftuar dhunën në familje apo për të ndihmuar viktimat, edhe pse këtë ndihmë e ofruan organizatat joqeveritare. OJQ-të raportuan se funksiononin tetë linja telefonike enkas për dhunën në familje. Linjat, të cilat shërbenin kryesisht për pjesën veriore të vendit, merrnin secila afërsisht 25 telefonata në muaj nga femra që raportojnë ndonjë formë dhune. OJQ-të administronin katër streha për femra të dhunuara në Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe Gjirokastër. OJQ-të shënuan një rritje në raportimet mbi dhunën në familje, në radhë të parë për shkak të ndërjegjësimit më të madh mbi shërbimet dhe besimit më të madh te policia. Sipas shifrave të qeverisë, pati 1744 raste dhune në familje të raportuara gjatë vitit, krahasuar me 1063 në vitin 2009. Shpesh policia nuk ka trajnimin ose kapacitetet për të shqyrtuar raste të dhunës në familje. Në shumë komunitete, veçanërisht ato në verilindje, gratë ishin objekt i diskriminimit shoqëror si rezultat i normave tradicionale shoqërore që i konsideronin gratë të varura nga burrat.

Ligji ndalon ngacmimin seksual; megjithatë, rrallë u zbatua ligji nga zyrtarët.

Të drejtat riprodhuese respektohen nga qeveria. Çiftet dhe personat kanë të drejtë të vendosin lirshëm numrin, distancën dhe kohën për të pasur fëmijë dhe kanë informacion dhe mjete për ta bërë këtë pa diskriminim, forcë apo dhunë. Shtetasit kanë akses ndaj kontraceptivëve. Sipas ligjit, kujdesi shëndetësor u ofrohet të gjithë shtetasve; megjithatë, cilësia dhe aksesit ndaj

kujdesit, përfshirë kujdesin obstetrik dhe pas lindjes, ishin të pakënaqshëm, sidomos në zonat e largëta rurale. Sipas përlllogaritjeve të OKB-së për vitin 2008, shkalla e vdekshmërisë së nënave në lindje në Shqipëri është 31 vdekje për 100 000 lindje. Gratë diagnostikohen e trajtohen në mënyrë të barabartë për infeksione të transmetuara seksualisht, përfshirë edhe HIV-in.

Ligji siguron të drejta të barabarta për meshkujt dhe femrat sipas kodit të familjes, ligjit për pronën dhe në sistemin gjyqësor. As ligji dhe as praktika nuk i përjashtonte femrat nga ndonjë post; megjithatë, ato nuk ishin të mirëpërfaqësuara në nivelet më të larta të fushave të tyre. Ligji kushtëzon pagesë të barabartë për punë të barabartë; megjithatë, qeveria dhe punëdhënësit nuk e zbatonin plotësisht këtë dispozitë.

## Fëmijët

Në 4 nëntor parlamenti aprovoi ligjin “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.” Ky ligj siguron kornizën ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në përgjithësi, prindërit duhet t’i regjistrojnë fëmijët në të njëjtin komunitet ku janë të regjistruar vetë. Megjithatë, sipas Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve të Shqipërisë (CRCA), fëmijët e lindur nga migrantë të brendshëm ose prej personave të kthyer nga jashtë shtetit shpesh nuk kishin certifikata lindjeje apo dokumente të tjera ligjore dhe, për pasojë, nuk ishin në gjendje të ndiqnin shkollën. Ky ishte problem në veçanti për familjet romë gjithashtu, të cilët shpesh martohen në moshë të re dhe nuk i regjistrojnë fëmijët e tyre.

Ligji siguron nëntë vite arsim falas dhe autorizon shkollat private. Ndjekja e shkollës është e detyrueshme deri në klasën e nëntë ose deri në moshën 16 vjeç, cilado arrihet më parë; megjithatë, në praktikë, shumë fëmijë e braktisën shkollën më herët se sa e lejonte ligji për të punuar me familjet e tyre, veçanërisht në zonat rurale. Prindërit duhet të blenin pajisjet, librat, uniformat dhe ngrohës për disa klasa, diçka e pamundur financiarisht për shumë familje, veçanërisht për romët dhe pakica të tjera. Shumë familje gjithashtu përmendën këto kosto si arsye për mosdërgimin e vajzave në shkollë.

Ashtu si në vitet e mëparshme, abuzimi i fëmijëve, përfshirë abuzimin seksual, ndodhën me raste, edhe pse viktimat rrallë e raportonin atë. Në disa raste fëmijë nën moshën 18 vjeç u përfshinë në prostitucion. Dënimet për shfrytëzim seksual të fëmijëve për përfitim variojnë nga gjoba deri në 15 vjet burg. Vendi ka një ligj statutor për përdhunimin dhe mosha për të kryer seks me konsensus është 14 vjeç. Dënimi për përdhunim statutor të një fëmije nën moshën 14 vjeç është burgim nga pesë deri në 15 vjet. Ligji ndalon bërjen dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë, dhe dënimet janë gjobë prej një deri në pesë milionë lekë (10 000 deri në 50 000 dollarë) dhe dënim me burg një deri në pesë vjet. Martesa e fëmijëve mbetet problem në shumë familje romë dhe ndodhte në mënyrë tipike në moshat 13 ose 14 vjeç.

Pati raporte se jetimët që largoheshin nga kujdestaria e shtetit në moshë të rritur përballeshin me sfida të mëdha për të gjetur shtëpi dhe shërbime të përshtatshme.

Fëmijët e zhvendosur dhe ata të rrugës mbetën problem, sidomos fëmijët romë, të cilët përbënin deri 90 përqind të fëmijëve të rrugës. Fëmijët e rrugës lypnin ose bënin punë të vogla; disa migruan në vendet fqinje, veçanërisht gjatë verës. Këta fëmijë gjendeshin përballë një rreziku më të madh për trafikim dhe disa u bënë viktimat e trafikimit.

Vendi është palë në Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të

Fëmijëve të vitit 1980. Për informacion mbi rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve nga prindërit, shikoni raportin vjetor të Departamentit të Shtetit në adresën [http://travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport\\_4308.html](http://travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport_4308.html).

## Antisemitizmi

Sipas raporteve, më pak se 100 çifutë jetonin në vend; nuk dihet të ketë sinagoga funksionale apo qendra komunitare dhe nuk pati raporte për akte antisemitizmi.

## Trafikimi i Personave

Raporti i përvitshëm për Trafikimin e Personave i Departamentit të Shtetit mund të gjendet në adresën [www.state.gov/g/tip](http://www.state.gov/g/tip).

## Personat me Aftësi të Kufizuara

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin kundër personave me aftësi të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore. Megjithatë, punëdhënësit, shkollat, ofruesit e kujdesit shëndetësor, si dhe ofrues të shërbimeve të tjera shtetërore shpesh diskriminuan ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ligji kërkon që ndërtesat e reja të jenë të arritshme për personat me aftësi të kufizuara, por kjo kërkesë u zbatua vetëm në mënyrë sporadike nga qeveria. Varfëria e përhapur gjerësisht, kushtet e pasiguruara të punës, si dhe kujdesi i dobët shëndetësor përbënin problem domethënës për shumë persona me aftësi të kufizuara.

Gjatë vitit, avokati i popullit vazhdoi të kontrollonte institucionet e shëndetit mendor dhe konstatoi se edhe pse kushtet fizike në mjediset në Vlorë dhe Shkodër ishin përmirësuar, ato nuk përmbushnin standardet dhe mbeteshin me mungesë stafi. Në kontrollet e Spitalit Psikiatrik të Tiranës u konstatua se disa dritare dhe dyer duheshin zëvendësuar për arsye sigurie. Avokati i popullit kryen rregullisht kontrolle në gjithë Shqipërinë. Ky institucion rekomandoi rishikim gjeneral të buxhetit ligjor dhe organizativ të sistemit të kujdesit për shëndetin mendor në vend. Pranimi dhe lirimi i pacientëve në institucione të shëndetit mendor ishte problem si pasojë e mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të siguruar vlerësime psikiatrike të mjaftueshme.

## Pakicat Kombëtare/Racore/Etnike

Pati raportime për diskriminim nga shoqëria. Si pakica të dukshme, anëtarë të bashkësive rome dhe egjiptianëve ballkanikë vuajtën abuzim dhe diskriminim të madh nga shoqëria. Ligji lejon statusin zyrtar të pakicës për grupet kombëtare dhe veçmas për grupet etnogjuhësore. Qeveria i përkufizoi grekët, maqedonasit dhe malazezët si grupe kombëtare; grekët përbënin grupin më të madh të këtyre. Ligji i përkufizoi arumunët (vllehët) dhe romët si grupe pakicash etnogjuhësore.

Në tetor, Këshilli i Ministrave miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për Dhjetëvjeçarin e Përfshirjes së Romëve dhe Egjiptianëve për periudhën 2010-15. Buxheti total për zbatimin e planit pesë-vjeçar pritej të ishte afërsisht 2.5 miliardë lekë (25 milionë dollarë).



Pakica etnike greke ndoqi pakënaqësitë me qeverinë lidhur me zonat zgjedhore, arsimin në gjuhën greke, të drejtat e pronësisë dhe dokumentat qeveritare. Udhëheqës të pakicës përmendën mungesën e vullnetit të qeverisë për të njohur qytetet greke etnike jashtë “zonave të pakicave” të kohës së komunizmit; për të përdorur greqishten në dokumente zyrtare dhe në shenjat publike në zonat etnike greke; për të përcaktuar përmasat e popullsisë etnike greke; apo për të përfshirë një numër më të madh grekësh etnikë në administratën publike.

Gjatë vitit prokurorë të qeverisë vazhduan të apelonin heqjen e akuzave kundër Vasil Bollanos, kryebashkiaku me kombësi greke i Himarës, i cili u shpall fajtor për abuzim me detyrën, por dënimi i të cilit u përmbys në apel në qershor të vitit 2009. Gjykata e dënoi Bollanon për shpërdorim të pronës së shtetit pasi ky i fundit urdhëroi heqjen e disa shenjave në rrugë në zonën e Himarës sepse ato ishin shkruar në gjuhën shqipe e angleze dhe jo në atë greke.

Abuzimet, Diskriminimet dhe Aktet e Dhunës nga Shoqëria Bazuar mbi Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor

Nuk ka ligje që kriminalizojnë orientimin seksual dhe ligji nuk bën dallime midis llojeve të marrëdhënieve seksuale. Pati organizata lesbike, gay, biseksuale dhe transgjinore (LGBT) në vend. Grupet funksionuan pa ndërhyrje nga policia apo aktorë të tjerë shtetërorë. Pati raportime të përsëritura për individë të rrahur, pushuar nga puna, apo të diskriminuar për shkak të orientimit të tyre seksual. Shpesh, këto raste nuk raportoheshin.

OJQ-të deklaruan se policia në mënyrë rutinë ngacmonte persona të kategorisë LGBT dhe punëtorë transgjinorë.

Të Tjera Akte Dhunimi Shoqëror ose Diskriminimi

Vendi ka përhapje të ulët të HIV/SIDA. Ekziston një turp i përgjithshëm shoqëror kundrejt personave me HIV/SIDA; megjithatë, nuk pati raportime dhunimi kundrejt këtyre personave gjatë vitit. Strukturat ligjore të vendit ndalojnë diskriminimin; megjithatë, mungonte zbatimi në disa raste. Sipas ligjit gjithë shërbimet shëndetësore sigurohen falas.

Seksioni 7 Të Drejtat e Punëtorëve

a. E Drejta e Shoqatës

Punëtorët kanë të drejtën të formojnë sindikata të pavarura dhe e ushtruan këtë të drejtë në praktikë; megjithatë, ligji ndalon anëtarët e ushtrisë dhe zyrtarët e lartë qeveritarë të bashkohen në sindikata dhe kërkon që një sindikatë të ketë të paktën 20 anëtarë për t’u regjistruar. Afro 18 përqind e forcës punëtore ishte pjesë e sindikatave.

Ligji lejon të drejtën për grevë për të gjithë punonjësit, me përjashtim të nëpunësve civilë dhe punëtorët e ushtruan këtë të drejtë në praktikë. Nëpunësit civilë nuk kanë të drejtë të kryejnë greva; kjo ka vlerë për pjesën pa uniformë të ushtrisë, policisë, personelin e domosdoshëm mjekësor dhe spitalor, personat që ofrojnë kontroll të trafikut ajror dhe shërbimet e burgjeve, si dhe punëtorët e domosdoshëm dhe jo të domosdoshëm në ndërmarrjet e ujit dhe energjisë. Ligji ndalon grevat që gjykatat i gjykojnë si politike.

b. E Drejta për T’u Organizuar dhe Negociuar Kolektivisht

Shtetasit në të gjitha fushat e punësimit civil kanë të drejtën kushtetuese të organizohen dhe të

negociojnë kolektivisht dhe ligji përcakton procedura për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet marrëveshjeve kolektive të negociimit. Megjithatë, sindikatat funksiononin nga pozita të dobëta. Në praktikë, sindikatat që përfaqësonin punonjësit e sektorit publik negocionin drejtpërdrejt me qeverinë. Negociimi kolektiv i efektshëm mbeti i vështirë dhe marrëveshjet ishin të vështira për t'u vënë në zbatim. Gjatë vitit, parlamenti miratoi një ligj që u kërkonte organeve përfaqësuese të punëtorëve në ndërmarrje me 20 apo më shumë punëtorë që të informonin punëtorët për të gjitha çështjet që ndikonin ata dhe kompanitë e tyre.

Ligji nuk ndalon diskriminimin antisindikatë dhe pati disa raportime për ndodhi të tilla. Sipas Sindikatës së Pavarur të punonjësve të Tekstileve, Veshjeve dhe Lëkurës, punëdhënësit në sektorët e veshjeve, lëkurës dhe këpucëve i shihnin sindikatat si armike. Sipas raportimeve, ato kishin kërcënuar të zhvendoseshin jashtë vendit nëse punëtorët krijonin sindikata. Në prill Gjykata Kushtetuese përmbysi ligjin e vitit 2009 që mund të përdorej për të sekuestruar prona që u takonin sindikatave të vendit.

Nuk ka zona përpunimi për eksport, zona tregtie të lirë apo parqe industriale.

#### c. Ndalimi i Punës me Forcë ose Të Detyruar

Ligji ndalon punën me forcë ose të detyruar, përfshirë atë të kryer nga fëmijët; megjithatë, femrat dhe fëmijët trafikoheshin për shfrytëzim seksual dhe si krahë pune. Për më shumë informacion mbi punën me forcë dhe të detyruar, shikoni raportin vjetor të Departamentit të Shtetit mbi Trafikimin e Personave në adresën [www.state.gov/g/tip](http://www.state.gov/g/tip).

#### d. Ndalimi i Punës së Fëmijëve dhe Moshë Minimale për Punësim

Ligji kriminalizon shfrytëzimin e fëmijëve për shërbime pune apo me forcë; megjithatë, qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë të efektshme. Sipas një përlllogaritjeje të CRCA, nxjerrë gjatë vitit, më shumë se 50,000 fëmijë nën moshën 18 vjeç punonin të paktën me kohë të pjesshme. CRCA raportoi se shumica e punëtorëve fëmijë punonin si shitës rruge apo dyqanesh, lypës, fermerë apo barinj, shpërndarës droge, larës makinash, punëtorë të fabrikave të tekstileve, minatorë, apo ilustraxhinj. Kërkimet treguan se lypja fillonte në moshë të vogël, madje që katër apo pesë vjeç. Kodi penal e ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje. Përgjithësisht policia nuk e ka vënë në zbatim këtë ligj.

Ligji përcakton moshën minimale të punësimit në 16 vjeç dhe rregullon sasinë dhe llojin e punës që mund të kryejnë fëmijët nën moshën 18 vjeç. Fëmijët midis moshave 16 dhe 18 vjeç mund të punojnë vetëm në disa punë të përcaktuara. Ligji parashikon që Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse për zbatimin e kërkesave për moshën minimale me anë të gjykatave; megjithatë, nuk pati raporte të zbatimit të kësaj përgjegjësie. Inspektorët e punës hetonin sektorin formal të punës, ndërkohë që pjesa më e madhe e punës së fëmijëve ndodhte në sektorin informal. Shumica e hetimeve ishin në fabrikat e këpucëve dhe tekstileve dhe u gjetën raste punësimi të fëmijëve në disa prej këtyre inspektimeve.

Në vitin 2008, një shpërthim masiv në një bazë ushtarake në zonën e Gërdecit, ku municioni i vjetër sigurohej, vrau 26 persona, përfshirë këtu edhe një numër fëmijësh të punësuar në mënyrë të jashtëligjshme. Shpërthimi lëndoi qindra të tjerë, disa prej tyre rëndë.

Qeveria, së bashku me një numër OJQ-sh dhe donatorësh ndërkombëtarë kishin disa programe

specifike që synonin parandalimin e punës së jashtëligjshme të fëmijëve. Gjatë vitit, Njësia e Punës së Fëmijëve në Ministrinë e Punës vazhdoi zbatimimin e fazës së dytë të nismës së saj për monitorimin e punës së fëmijëve në rajonet e Elbasanit dhe Shkodrës. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, 362 fëmijë u hoqën nga forma të ndryshme punësimi dhe u kthyen në shkollë. Gjithashtu, Ministria e Turizmit vendosi një kod sjelljeje për parandalimin e turizmit të seksit të fëmijëve që u nënshkrua nga 24 agjenci turistike dhe hotele.

#### e. Kushtet e Pranueshme të Punës

Paga minimale kombëtare ishte 20 000 lekë (190 dollarë) në muaj. Megjithatë, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të siguruar standard të pranueshëm jetese për punonjësin dhe familjen e tij. Sipas INSTAT-it, paga mesatare për punonjësit e qeverisë në çerekun e tretë të vitit ishte 47 000 lekë (447 dollarë) në muaj. Instituti Shqiptar i Statistikave raportoi gjithashtu se pagat mesatare mujore në sektorin publik ishin rritur me 6,4 përqind nga viti 2009. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka përgjegjësinë për zbatimimin e direktivës për pagën minimale.

Ligji përcakton javën 40-orëshe të punës; megjithatë, marrëveshjet individuale ose kolektive janë ato që përcaktojnë javën e vërtetë të punës. Shumë persona punonin gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pagimin për orët shtesë të punës dhe për pushimet; megjithatë punëdhënësit nuk i zbatonin gjithmonë këto dispozita në praktikë. Qeveria nuk kishte standarde për numrin minimal të periudhave të pushimit në javë, as kufij në numrin maksimal të orëve të punës në javë e as rregullore në lidhje me vlerën e pagesës për orët shtesë. Qeveria nuk ndalonte punën shtesë tejet të detyruar.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse për zbatimimin e standardeve dhe rregullores për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës; megjithatë, mungonte në të gjithë gamën zbatimi i tyre. Kushtet në vendin e punës shpesh ishin shumë të këqija dhe në disa raste të rrezikshme. Punonjësit në minierën e Bulqizës vazhduan të kërkonin moshë pensioni më të ulët. Në vend të kësaj, qeveria nxorri rritje rroge për minatorët që punonin pas moshës 50 vjeç. Kërkesa të tjera të minatorëve përfshinin shërbime më të mira mjekësore për minatorët që aksidentohen në punë dhe përmirësim të statusit të tyre ligjor si minatorë. Ministria përkatëse e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës u përpoq në mars të risillte në përdorim mekanizmin e Njesisë së Kontrollit dhe Shpëtimit të Minierave, e cila ka qenë e pranishme për 50 vitet e fundit. Qeveria krijoi gjithashtu një taskforcë me autoritete qendrore dhe lokale, të administrimit të taksave dhe të policisë së shtetit për të përmirësuar zbatimimin e ligjit në zonë.

U raportuan disa aksidente në minierat e Bulqizës gjatë vitit. Shumica e aksidenteve përfshinin shembje në miniera dhe vinin si rezultat i mungesës së masave dhe procedurave të sigurisë. Në maj një punonjës miniere 65 vjeçar, sipas raportimeve, kishte vdekur në një aksident në vendin e punës duke punuar në një prej minierave të Bulqizës. Gjatë vitit grupe mediatike raportonin se gra dhe të mitur mblihdnin krom nga minierat për të ndihmuar familjet e tyre.

Ligji nuk u garanton punonjësve të drejtën të largohen nga situata të rrezikshme pa rrezikuar humbjen e vendit të tyre të punës.